



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 20.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 18.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "EJONA" për aktivitetin :"**Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa e Operatorit Ekonomik "EJONA" e datës 18.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit " :"**Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521 kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,dërguar me datën 14.08.2020 dhe publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Vertetohet Vendimi i publikuar me datë: 14.08.2020;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "EJONA" me datë 18.08.2020 ka parashtruar ankesën, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:" **Vendosja,rregullimi dhe riparimi i ashensoreve**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2517-521. Autoriteti Kontraktues, me datë 20.08.2020, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Pretendimi i pare lidhur me mospermbushjen e kriterit per qarkullim financiar eshte i pa bazuar,pasi qe vetem anetari :Rima Engeniering"ka dorezuar deshmi nga ATK-ja se per vitet 2017 dhe 2018 ka qarkullim financiar ne vlere prej 621,828.75 €;

Pretendimi tjetër se nuk janë përmbushur kërkesat tjera teknike dhe profesionale poashtu është i pa bazuar,pasi qe grupi ka deshmuar se ploteson kërkesat lidhur me referencat dhe kualifikimet e përvojen e stafit;

-Pretendimi vijues lidhur me çmimet jo normalisht te ulta te tenderuesit te propozuar per dhenje te kontrates ju sqarojme se nuk jane plotesuar kushtet per te trajtuar tenderin si te tille, respektivisht ne kete rast mund te trajtohet si i tille çdo tender qe do te kishte çmimin nen vleren prej 132,057.88 euro, ndersa per te vleresuar raportet lidhur me çmimet per pozicione ,kjo e dini edhe ju se eshte ne kompetencen e AK-se.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit